



Rr. "Abdi Toptani", ish Hotel Drini



info@kmshc.al



www.kmshc.al

13 Janar 2025

NJOFTIM

PËR TAKIMIN E ZHVILLUAR MIDIS PËRFAQËSUESVE TË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL DHE KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NË KUADËR TË PROCESIT ZGJEDHOR PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË

Në datën 10 janar 2025, në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen e Shërbimit Civil, u zhvillua një takim ndërmjet Komisionerit dhe Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK).

Gjatë këtij takimi u diskutuan çështjet kryesore të mëposhtme:

1. Ngritja e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP) dhe të Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet (KKSK)

Tashmë është hartuar baza ligjore e nevojshme për krijimin dhe vendosjen në funksion të këtyre organizmave.

2. Procesi i Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të majit 2025

U analizua situata socio-politike aktuale dhe sfidat me të cilat përballlet procesi zgjedhor, si: moscenimi i lirive dhe të drejtave politike të shtetasve; moshpërdorimi i burimeve shtetërore; intimidimi dhe përdorimi i papërshtatshëm i punonjësve të administratës publike për qëllime elektorale.

Nga ana e KRIIK, u vlerësua udhëzuesi i nxjerrë nga Komisioneri në kuadër të procesit zgjedhor gjatë zgjedhjeve të kaluara, dhe për shkak të rëndësisë që ai ka në mbarëvajtjen e këtij procesi, u kërkua që këtë vit ky udhëzues të nxirret sa më shpejt të jetë e mundur.

Njëkohësisht, përfaqësuesit e Komisionerit vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm mes dy institucioneve, duke theksuar rëndësinë e vazhimit të këtij bashkëpunimi për përmirësimin e proceseve institucionale dhe demokratike.